



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 456 Prot.

Tiranë, më 02.07 2015

VENDIM Nr. 75 datë 23.06.2015

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 41 dhe 43, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.9, të datës 23.06.2015, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor të ri "Kërkime arkeologjike të Antikitetit të Vonë dhe Mesjetës në Luginën e Sipërme të Vjosës"* paraqitur nga Universiteti "Aleksandër Xhuvani", Fakulteti i Shkencave Humane, Elbasan, miratuar nga Këshilli i Fakultetit të Shkencave Humane, drejtues Prof. As Ylli Cerova (Universiteti "Aleksandër Xhuvani", Qendra e Studimeve Albanologjike-Ballkanologjike, Elbasan); Ardit Miti (Qendra e Kërkimeve dhe Promovimit të Peisazheve Historiko-Arkeologjike Shqiptare, Tiranë) Eglantina Serjani (Qendra e Kërkimeve dhe Promovimit të Peisazheve Historiko-Arkeologjike Shqiptare, Tiranë),

VENDOSI:

- I. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor të ri "Kërkime arkeologjike të Antikitetit të Vonë dhe Mesjetës në Luginën e Sipërme të Vjosës"* paraqitur nga Universiteti "Aleksandër Moisiu", Fakulteti i Shkencave Humane, Elbasan, drejtues Prof. As Ylli Cerova (Universiteti "Aleksandër Xhuvani", Qendra e Studimeve Albanologjike-Ballkanologjike, Elbasan); Ardit Miti (Qendra e Kërkimeve dhe Promovimit të Peisazheve Historiko-Arkeologjike Shqiptare, Tiranë) Eglantina Serjani (Qendra e Kërkimeve dhe Promovimit të Peisazheve Historiko-Arkeologjike Shqiptare, Tiranë), në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
- Survej arkeologjik, i cili do të nisë në zonën e paracaktuar të projektit për njohjen e territoreve mes qytetit të Përmetit në veri dhe pikës kufitare të Tri Urave (në jug), në të dy krahët e rrjedhjes së lumit Vjosë.
 - Survej gjeofizik dhe gjeokimik, i cili do të kryhet në dy sitet e zbuluara gjatë sezonit të vitit 2011, përkatësisht në Magjiricë dhe Lëmenjëz.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

- Sondazhe arkeologjike të cilat do të kryhen në sitet e Magjiricës dhe Lëmenjëzës, brenda zonave të sipërpërmendura të survejit gjeofizik dhe gjeokimik.
- II. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë brenda gjashtëmuajorit të dytë të vitit 2015.
- III. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTËR



SEKRETARI KKA

RUDINA ZOTO